
POEMA E NAIM FRASHËRIT “O ALITHIS POTHOS TON SQIPETARON” (DËSHIRË E VËRTETË E SHQIPËTARËVE) DHE PLATFORMA E IDEOLOGJISË KOMBËTARE SHQIPTARE

PANAJOT BARKA

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë

panajotbarka@yahoo.gr

Abstract

It is written in 1886, in Greek language katharevusa¹, when N. Frashëri was 40 years old. It consists of about 500 stanzas of 15-syllables.

The poem was translated into Albanian language by Kristo Luarasi and was published in Sofia in 1904. The second edition of the poem, the translated version into Albanian done by the Kristo Floqi, was published in 1912. The poem was republished and came out in circulation in the ‘80 of the last century, being translated by the well known Greek minority poet, Pano Çuka. It is visibly influenced by Homer and the Greek culture.

The Poem was written during the period of “Eastern Crisis” and difficulties that came up in the process of formation of nation-states in the Balkans. The Prizren League had failed to give a clear answer on the true aspirations of “Albanianism”. The “Albanianism” itself as a process of creating national identity was affirmed by the controversy way on the relations with neighbors. During this time, in the Albanian society was created the “middle class” – being the lucky yeast for the development of the new national identity, to which belonged Naim Frashëri. In Europe the first steps were made to Albanology.

It was written in Greek because the Greek language was the language of the Balkan elite of that time. There were many the Albanians who had no opportunity of education in their mother language, so they had to use the written Greek as a language to communicate. The Albanian National Movement felt the need to promote its program and its aspirations to the international actors and the Greek language could provide this opportunity.


The Poem is written in the spirit of an ideology, which on behalf of the aspiration of creating a new national identity, intermingled in a harmonic way the two antipodal movements of that time - Enlightenment and Romanticism. This aim was seen as the integrity of three main directions; the promotion of a glorious historical genesis and tradition for his people, secondly to convey this reality to the common people and making them aware about the fact

¹ Form of the new Greek language based on the cultivated tradition.

Poema e Naim Frashërit “O alithis pothos ton sqipetaron” (Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve)

that they were worthy successors of this glorious historical reality aiming to orient them to the road to freedom. The third direction is linked to the necessity of recognizing this reality from the outside world. This new ideology has inspired and materialized the Greek Revolution. As such the Poem embraces the whole spectrum of problems that rose during the Albanian National Renaissance Movement; it specifies the aspirations of the Albanian people in relation to themselves and takes the role of the guide on regards to the definitions and literary and academic platforms on the ethno-genesis and Albanian origin. Therefore, the Poem remains an emblematic document of the Albanian National Renaissance Movement.

Keywords: Renaissance Movement, Eastern Crisis, Albanianism, neighbors, aspirations



Kopertinë e poemës,

Hyrje parathënëse

Poema “Ο αληθής πόθος των Σκυπετάρων” (O allithis pothos ton sqipetaron- Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve) e Naim Frashërit, shkruar në vitin 1886, përbën veprën që parashtron në formën më të plotë platformën e ideologjisë kombëtare shqiptare të kohës së tij. Ngërthen gjithë problematikën që kjo ideologji u thirr të përpunonte e të përballonte në kushtet specifike për çeshtjen kombëtare të

shqiptarëve. Për arritjen e qëllimeve të veta, Naim Frashëri bazohet në parimet kryesore të rrymave ideologjike evropiane të kohës për krijimin e shteteve etnike apo komb-shteteve.

Tezat ideologjike dhe politike të parashtrura prej tij në poemë, në vija të përgjithshme, i qëndruan kohës si model të ideologjisë kombëtare shqiptare deri në ditët tona.

Do të mjaftonte vetëm kjo vepër për ta radhitur Naimin në pararojën e figurave të shquara të Rilindjes Kombëtare dhe të Shqiptarësisë.

Platformat ideologjike të lëvizjeve kombëtare në Ballkanin e shekullit XIX

Shekulli XIX i Ballkanit u karakterizua nga vërshimi i lëvizjeve kombëtare që synonin krijimin e komb-shteteve të popujve të këtushëm. Motivoheshin kryesisht nga shpërbërja e pjesës evropiane të Perandorisë Otomane (Kriza e Lindjes) dhe instrumentalizoheshin nga Fuqitë e Mëdha. Në realitetin e Evropës Perëndimore “*nacionalizmat në Ballkan ishin ngushtësisht të lidhur me fatin e popullsisë të krishtera nën mbrojtjen e Fuqive të Mëdha*”.²

Në përgjithësi, këto lëvizje reflektonin ambicien e sovranitetit në lidhje me përcaktimin e identitetit dhe hapësirës gjeografike etnike, ose territorin e shtetit kombëtar. Presupozonin një komunitet homogjen që synonte legalizimin e veprimit politik (krijimin e komb-shtetit) me mjete kulturore “të huazuara” nga e kaluara.³ U drejtoheshin thellësive të historisë me synim përcaktimin, krijimin apo dhe kultivimin e një etnogjeneze, të shndritshme dhe të lavdishme, e cila do të ishte e aftë të karakterizonte në vijim gjithë perspektivën historike të këtij komuniteti dhe do të vihej në shërbim të kultivimit të një ndërgjegjeje të përbashkët, atë kombëtare,⁴ me hap vijues krijimin e një kombi të pavarur, të përkushtuar në ruajtjen dhe përçarjen e kujtesës së veçantë lidhur me historinë, kulturën e tij dhe me identitetin e përbashkët kombëtar.⁵

Në aspektin ideologjik, përshkoheshin nga dy rrymat e ideologjisë së re të komb-shteteve në përgjithësi në Evropë, atë kozmopolite dhe tjetra mbi bazë racore, realisht

² Nathalie Clayer, *Aux origines du nationalisme albanais, La naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe*, Paris, 2007, f. 10.

³ Παντελής Ε. Λέκκας, *Το παιχνίδι με τον χρόνο: εθνικισμός και νεωτερικότητα, Ελληνικά Γράμματα*, Αθήνα, 2001, f. 107.

⁴ Κωνσταντίνος Τσουκαλάς, “Παράδοση και εκσυγχρονισμός: μερικά γενικότερα ερωτήματα”, në *Τσαούσης, Δ. Γ., (επιμ.), Ελληνισμός και ελληνικότητα*, Εστία, Αθήνα, 1983, f. 42.

⁵ Serge Bernstein, Pierre Milza, *Ιστορία της Ευρώπης: από την Ρωμαϊκή Αυτοκρατορία στα Ευρωπαϊκά Κράτη 5ος-18ος αιώνας*, v. Β', Αλεξάνδρεια, Αθήνα. 1999, f. 31.

Poema e Naim Frashërit “O alithis pothos ton sqipetaron” (Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve)

kundërshtuese apo reciprokisht përjashtuese midis tyre.

E para, kishte parasysh marrëdhënie të identifikueshme midis individëve, pjesëtarë të një kombi, të cilat duhet të përbëjnë një vlerë të qëndrueshme diakronike, pavarësisht marrëdhënieve me të tretët.

E dyta, ajo e kombit me bazë racën, e kërkonte identitetin kombëtar në karakteristika të përbashkëta objektivist të verifikueshme: gjuhë, doke, zakone, gjak, por, përjetësisht të pandryshueshme, që i garanton pastërtia etnike e pandikuar nga përzierje racore.

Të dyja këto platforma u korrespondojnë dy rrymave ideologjike antipode të kohës në Evropë, iluminizmit dhe romantizmit. Tërheq vëmendjen fakti se në të dyja këto platforma të ideologjisë së re kombëtare, sidomos tek e dyta, nevoja e kombinimit të iluminizmit dhe romantizmit ishte determinante.

Kjo ka të bëjë me rrethanat historike që ato u thirrën për t’u shërbyer. Rasti i parë, ai i natyrës kozmopolite, i korrespondon krijimit të komb-shteteve në Perëndim si nevojë e sistemit të ri ekonomiko-shoqëror, kapitalizmit. Rasti i dytë, ai komb-shteteve mbi bazë racën, synonte krijimin e komb-shteteve të dala nga shpërbërja e Perandorisë Otomane. Në rastin e dytë, projeksioni iluminist për ndriçimin e mendjes si ndërgjegjësim kombëtar dhe arritjen e kohezionit të brendshëm të popullit, si premisë për arritjen e çlirimit nga okupimi, por edhe si mundësi për të provuar në Perëndim barasvlefshmërinë e civilizimit me të dhe aftësinë shtetformuese, nuk mund të arrihej pa vënë në dukje një rrugëtim të lavdishëm historik dhe me një pikënisje të ndritshme origjine dhe etnogjeneze. Kjo vlerë iluministe mund të arrihej vetëm përmes qasjes romantike të historisë.

Qasja romantike e historisë u imponua edhe nga kërkesa për vetpërcaktimin më të mirë të EGO-s kombëtare nëpërmjet ballafaqimit me të TJERËT, të tretë që mund të ishin pushtues, armiq, fqinj apo dhe vetë Perëndimi.

Veçoritë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (Rilindja Kombëtare)

Pjesë e këtij areali lëvizjesh kombëtare të popujve të Ballkanit të shekullit XIX u bë edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare, e njohur si Rilindja Kombëtare. Ajo pati veçoritë e veta, shpesh të dallueshme nga lëvizjet kombëtare të popujve të tjerë ballkanas. Së pari, krahasuar me to, shfaqet e vonuar. “*Në fillimet e 1870-ës, shqiptarëve iu desh të lidheshin dhe të përqafojnë teorinë moderne të kombit*”⁶, thekson akademiku amerikan George W. Gawrych. Nathalie Clayer shënon se akoma edhe rrjeti i veprimtarëve të shqiptarizmit (*dhe jo lëvizja e mirëfilltë kombëtare, shën*

⁶ George W. Gawrych, *The Crescent and the Eagle*, London-New York, 2006, f. 32.

P.B) u zhvillua në çerekun e fundit të shekullit XIX⁷. Pra, bëhet fjalë për organizimin e një rrjeti dhe jo për zëra të veçantë të cilët e kishin nisur punën për ndërtimin e një identiteti kombëtar shqiptar që në fillim të shekullit XIX dhe jashtë realitetit shqiptar. Përmenden kryesisht arbëreshët e Italisë, si Angelo Masci, (1785-1821), i cili me 1807 botoi esenë me titull “Ligjërim mbi origjinën, zakonet dhe gjendjen e tanishme të kombit shqiptar”⁸, Giuseppe Crispi (1781-1859), i cili, në një libër të tij më 1831 shpalos tezën mbi lashtësinë e gjuhës shqipe që shkon deri te pellazgët dhe nënë të gjuhës greke⁹, Jeronim de Rada (1814-1903), i cili në një ese të tij më 1840-ën (ribotuar më 1864-ën) i mëshon idesë se gjuha dhe kombi shqiptar ishin më të vjetër se gjuha dhe kombi grek¹⁰ apo Vangjel Meksi, Anastas Byku, Naum Veqilharxhi, Jani Vreto, Kostandin Kristoforidhi etj, që vepronin në Greqi apo dhe në vende të tjera evropiane. Këta të fundit, ndërsa në fillimet e veta zhvillonin veprimtarinë e tyre në kuadrin e lëvizjes kulturore, madje dhe kryengritëse të Greqisë, në vijim dhe nën ndikimin e Shoqërisë Biblike “*British and Foreign Bible Society*”, u orientuan në kultivimin e gjuhës shqipe dhe të identitetit kombëtar shqiptar, për t’u bërë përfundimisht pjesëtarë aktivë të rrjeteve të Shqiptarizms dhe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.¹¹

Kjo lëvizje u ngjiz në kushtet kur tradicionalisht shqiptarët nuk shquheshin për një kohezion të brendshëm etnik, qoftë për shkak të larmisë së besimeve, por edhe të organizimit shoqëror. Sipas E.Vlorës “*Botëkuptimi i shumicës dërmuese në vitet 1900 deri 1906-ën ka qenë për të ardhur keq. Askush nuk e ndiente veten pjesëtar të një populli: Kudo që të ishte popullsia ndahej në dy kampe, të ndara e të prera si me thikë. Në njërin bënë pjesë ato tre të katërta që pyetjes se çfarë ishin, i përgjigjeshin, turk, i qofshim falë zotit, gjë që natyrisht nuk duhej kuptuar ngushtë, nuk duhej marrë në kuptimin e një përkatësie etnike, por të një përkatësie fetare. Çereku tjetër. Shqiptarët ortodoksë dhe hera-herë (por rrallë) edhe katolikë quheshin gjaurë, emërtim që jo vetëm i përçmonte, por edhe i ndante nga tërësia e popullit shqiptar, si një element i ndryshëm, madje do të thosha i huaj*”¹².

«Larmia e besimeve fetare në mes të shqiptarëve, shumica e tyre myslimanë dhe mungesa e shtetit apriori nuk mund ta fusnin këtë nacionalizëm në të njëjtin kuadër (me atë të popujve të tjerë ballkanas, shën. P.B). Përgjithësisht ai është trajtuar si një specifikë e qartë kundrejt nacionalizmave të tjera ballkanikë”¹³. Po sipas

⁷ Nathalie Clayer, po aty, f. 208-209.

⁸ Po aty, f.154

⁹ Jup Kastrati, Historia e Albanologjisë, Tiranë, 2000 f. 571-574

¹⁰ Girolamo de Rada, Divinazioni pelasgiche, Lucifero, 1840.

¹¹ Nathalie Clayer, Po aty, f. 162-172, 176-183, 189-193

¹² Eqrem bej Vlora, Kujtime, v. I, 1885-1912, SH.L.K, Tirana. 2001, f. 156.

¹³ Nathalie Clayer, Po aty, f.10.

ballkanologes franceze, përplasja e gjatë midis patriotëve shqiptarë për zgjedhjen e një alfabeti të vetëm për përdorimin e gjuhës shqipe ishte tregues se “*shqiptarizmit i duhej të ndeshej, po ashtu, edhe me probleme brenda vetë patriotëve shqiptarë, sidomos po të llogarisim peshën e identiteteve fetare e kulturore*”¹⁴

Për rastin e Shqipërisë, arritja e homogjenitetit etnik nuk u mbështet në një fe (as të krishterë, as myslimane), por në gjuhë. Për pasojë edhe pse nuk ishte një çështje e thjeshtë, në themel të kërkimit rilindas të mitit të origjinës vendin kryesor e zuri çështja e gjuhës shqipe.

Po ashtu, ekzistenca e marrëdhënieve të thelluara të shqiptarëve me P. Otomane, veçanërisht të atyre që ndërruan besimin, jo vetëm kufizonte dhe pengonte idenë e pavarësisë kombëtare, por vështirësonin edhe përcaktimin e etnogjenezës dhe mitit të saj, si edhe përcaktimin e territorit kombëtar, të vazhdimësisë etnike. Ky territor identifikohesh shpesh me tokat e vetë Perandorisë Otomane, pushteti i së cilës në to administrohej nga shqiptarët.

“*Thelbi i paktit (midis P. Otomane dhe shqiptarëve, shën P. B) përmbledhej në njëjën fatale: nëse donin të kishin bashkë perandorinë, duhej të jetonin e të vdisnin si turq... Përndryshe, si mund të mëtoje të kishe pjesë në perandori, duke qenë i huaj?*”¹⁵

“*Islamizimi luajti rol pozitiv në rajonet kufitare të trojeve shqiptare, si në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore e në Çamëri. Duke përqafuar fenë islame shqiptarët e atyre trojeve ruajtën karakterin etnik ndaj sllavizmit, serbizmit e greqizmit*” thotë në librin e tij universitar “Historia e Popullit Shqiptar 395-1875” Petrika Thëngjilli.¹⁶

“*Si mysliman, shqiptari, thekson studiuesja angleze M.Vickers, ishte aleat dhe i barabartë me otomanin, i cili e mbronte nga abuzimet e sllavëve dhe grekëve*”¹⁷. Ndërsa E. Çabej shton se “*Osmanët sollën në kulm dhe e përfunduan hovin shtegues të shqiptarëve dhe kontribuan në shpallimin e shpërndarjen e tyre, por jo krejt*”¹⁸.

Veçoria në fjalë shkaktonte trazime dhe dilema në ballafaqimin “ne” dhe “të tjerët” për vetëpërcaktimin më të mirë të “EGO-s” kombëtare. Ndryshe nga popujt e tjerë ballkanas që “të tjerët” identifikoheshin me armiqtë, pushtuesit, kryesisht P. Otomane, në rastin e shqiptarëve këta të tjerë, ishin fqinjët, veçanërisht të krishterët, kryesisht serbët, malazezët, grekët, të çliruar nga kjo Perandori.

¹⁴ Po aty, f. 216.

¹⁵ Isamil Kadare, Mosmarrëveshja mbi raportet e Shqipërisë me vetveten, Tiranë, 2010, f. 60-61.

¹⁶ Petrika Thëngjilli, Historia e Popullit Shqiptar 395-1875, ShBLU, Tiranë 1999, f. 31.

¹⁷ Miranda Vickers, The Albanians, a modern history, London -New York, 1995, f. 37.

¹⁸ Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, MÇM, Tiranë, 1994, f.17.

Poema dhe parimet e platformave ideologjike kombëtare

Më 1886-ën dhe në moshën 40-vjeçare, Naim Frashëri shkroi dhe botoi në gjuhën greke poemën “Dëshirë e vërtetë e shqiptarëve” (O alithis pothos ton skypetaron – O αληθής πόθος των σκυπετάρων).

Poema u shkrua në Janinë, kryeqendrën e vilajetit të Epirit, ku kultura perëndimore – evropiane ishte absolutisht mbisunduese mbi atë lindore. Në shkollat e Janinës u arsimuan dhe fituan kulturë të gjerë evropiane një pjesë e rëndësishme e ajkës shqiptare, që mori përsipër lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, midis tyre dhe vëllezërit Frashëri. “Në pjesën më të madhe ata ishin me origjinë nga vilajeti i Janinës, ose rajoni i Korçës dhe i takonin kulturës greke”¹⁹. Lidhja e ngushtë me helenizmin dhe arritjet e tij në përpunimin e ideologjisë së re kombëtare greke të njohur si Ideologjia e Neohelenizmit, ndikoi veçanërisht në ndërthurrjen në një linjë harmonike të dy lëvizjeve antipode të kohës – iluminizmin dhe romantizmin.

R. Qosja do ta cilësojë këtë vepër “një prej poemave më pak të njohura të Naim Frashërit, gjithsesi, njëra prej poemave të tij me ndikim më të vogël ndër lexuesit shqiptarë”.²⁰ E vërteta është se poema mund të mos jetë bërë e njohur si vepër letrare. Por, siç u tha që në fillim, në aspektin politik dhe ideologjik, ajo rrok gjithë spektrin e problematikës së Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare Shqiptare të kohës dhe shërbeu si arketip i ideologjisë kombëtare shqiptare për periudhat që pasuan.

Platforma ideologjike e politike së cilës iu referua në këtë vepër Naim Frashëri ishte ajo e krijimit të komb-shteteve që gërshetonte dy rrymat plotësisht të kundërta të kohës, iluminizmin me romantizmin. Dallohet qartazi se u ndikua nga modeli i lëvizjes ideologjike neohelene, që siç u theksua, u kultivua në Janinë ku vetë Naimi u formua.

Lëvizja shtetformuese që promovoi ideologjia neohelene ishte nga të parat në Ballkan, ose në pjesën evropiane të P. Otomane, e cila gërshetoi në kushtet e veta Iluminizmin me Romantizmin. Kjo përbënte një domosdoshmëri objektive. Nga njëra anë për të përcaktuar dhe promovuar epërsinë e EGO-s helene (kategoria NE) në ballafaqim me “TË TJERËT” që ishin përcaktuar qartësisht dhe vendosmërisht dhe identifikoheshin me pushtuesit Otomanë. Paralelisht, egzistonin dhe “ata”, perëndimorët, të cilët duhej të bindeshin se grekët e kohës ishin trashëgimtarë të denjë të civilizimit të lashtë helen dhe si të tillë e meritonin lirinë. Veç kësaj ideologjia neohelene ishte sprovuar suksesshëm në revolucionin grek të 1821-t, që kishte çuar në krijimin e shtetit kombëtar të Greqisë.

Pavarësisht sistemit referues, Naimi përcakton dhe sistemon themelet e ideologjisë rilindase shqiptare. Ai synon kultivimin e aspiratave të popullit shqiptar në raport me veten, historinë e tij dhe të tjerët, por edhe përsa i përket perspektivës historike.

¹⁹ Nathalie Clayer, Po aty, f. 215.

²⁰ Rexhep Qosja, Porosia e madhe, Prishtinë, 1986, f.170.

Me argument iluminizmin dhe qasjen romantike të historisë dhe duke rimarrë në konsideratë pikëpamjet po romantike të Masci-t, Crispi-t, de Radës etj, Naimi merr rolin e udhërrëfyesit për platformat historike, letrare e akademike mbi etnogjenezën, gjuhën dhe origjinën shqiptare, territorin e pretenduar kombëtar, kundërshtarët ndaj të cilëve duhej luftuar. “*Naim Frashëri është bërë ndërtuesi i sistemit të parimeve, të mendimeve dhe të ndjenjave, që në historinë e mendimit politik shqiptar, është quajtur shqiptarizëm*”, thotë në lidhje me këtë R. Qosja.²¹

Në këtë kuadër, pavarësisht qasjeve romantike të historisë së shqiptarëve prej Naimit dhe prej gjithë Rilindjes Kombëtare, si nevojë e tolerueshme e kohës, ato u shndërruan apriori në “të vërteta historike” që nuk lejonin verifikime dhe si të tilla, do të përdoren si argumente shkencore përcaktuese etnologjike deri në ditët tona. Në këtë mënyrë, poema mbetet dokumenti emblematik i Lëvizjes për Rilindjen Kombëtare Shqiptare.

Prezantimi i shkurtër i poemës

Botimi i parë, në Bukuresht më 1886-ën, në gjuhën greke nuk përmbante emrin e poetit. Dh. Shuteriqie argumentoi këtë fakt si qëndrim frike prej Naimit. “*Kuptohet se Naimi s’mund t’i firmoste këto vargje të një guximi të pashoq për kohën: ai i botoi pa emër autori*”.²² Ne mendojmë se bëhet fjalë për një risi romantike, aq e njohur deri në atë periudhë. Kujtojmë se në manifestin e parë politik të ideve të revolucionit frëng dhe iluminizmit evropian në Greqi, “*I elliniki nomarhia*”, hartuar në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XIX, autori i saj janiot mbetet ende anonim.

Më 1903-in, tre vjet pas vdekjes së poetit, poema ribotohet në Sofje po në gjuhën greke nga shtypshkronja shqiptare “Mbrothësia”. Disa ndryshime në të, siç pohon botuesi, ishin bërë nga vetë Naimi. Poema në këtë botim përbëhet nga 414 vargje. Vargu është pesëmbëdhjetëroreshi klasik popullor grek, pa rimë dhe me ritëm të brendshëm. Gjuha greke e zgjedhur edhe pse elitare (katharevusa) i përafrohet asaj popullore greke (dhimotiqi). “*Naimi e dinte me rrënjë gjuhën e bukur greke dhe shkroi një poemë që ishte në lartësinë e krijimtarisë së tij më të mirë dhe të dellit qytetar më të mirë të asaj gjuhe*”, thotë konkretisht Dh. Shuteriqi.²³

Në gjuhën shqipe vepra u përkthye nga greqishtja prej Kristo Luarasit dhe u botua në Sofje më 1904-ën me të njëjtat risi stilistike si në gjuhën greke. Botimi llogaritet i tretë, si vijimësi e dy botimeve në gjuhën greke, (Bukuresht 1886, Sofie 1903) dhe quhet “shtypja e tretë”. Në këtë logjikë ruan titullin në gjuhën greke “O

²¹ Rexhep Qosja, “Naim Frashëri dhe gjendja shpirtërore e popullit”, në *Naim Frashëri dhe kultura shqiptare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë, 2001, f. 13.

²² Dhimitër S. Shuteriqi, Naim Frashëri (Jeta dhe vepra), 8 Nëntori, Tiranë, 1982, f.163.

²³ Po aty f. 159

αληθής πόθος των Σκυπετάρων» dhe vendos posht në kllapa titullin e përkthyer në shqip (*Dëshira e Vërtetë e Shqiptarëve*). Në frontespis përdoret, gjithashtu, vargu i njohur i Homerit tek Iliada vënë në gojën e Hektorit “*Virtuti më i vyer mbetet mbrojtja e atdheut*”. U botua po nga shtypshkronja shqipe “Mbrothësia”.

Shqipërimi i dytë nga gjuha greke i takon Kristo Floqit. Në këtë botim u përdor alfabeti shqip i Stambollit. Titulli ishte “Dëshir” e vërtetë e shqiptarëve. Vjershë kombiare”. Në frontespis dallohen katër vargje nga poema e njohur e Naimit “Bagëti e Bujqësia”. Botimi i takon vitit 1912 dhe po nga shtypshkronja shqipe “Mbrothësia” që i takon tani Kristo Luarasit. Në këtë botim përkthyesi shton 68 vargje, si krijim autentik.

Edhe përkthimi i ri, brenda logjikës romantike ka si qëllim t’i shërbejë aktualitetit politik të kohës, shumë të ngjeshur dhe me ndryshime vendimtare historike për botën shqiptare.

Në shërbim të konjunkturave politike poema ridel në qarkullim në fundin e viteve 70’ të shekullit të kaluar. Përkthyes është poeti i njohur minoritar grek Panos Çukas. Duke qenë se qëllimi i tanishëm politik ishte përmirësimi i marrëdhënieve me Greqinë, përkthehen nga poema ato pjesë që i shërbejnë këtij synimi. Përkthimi i Çukës përmban 372 vargje nga 414 origjinali. Fakti përbën një tregues se poema ngërthen në vetvete vlera dhe kumte të gjithëkohshme.

Poema i takon fazës së dytë të krijimtarisë së poetit. Përshtohet nga pathosi i thellë epik patriotizmi, gërshetuar me një lirizëm meditativ, qortues dhe porosidhënës.

Konstatohet lehtësisht mjedisi romantik i poemës, veçanërisht në aspektin e qasjes historike, por gjithmonë bazuar në koncepte iluministe.

Nuk është befalusëse të thuhet se është i dukshëm ndikimi i Homerit. Naimi e lexon Homerin “*si ligjvënës të epopeve më të çmuara në historinë e letërsisë botërore*”²⁴.

Si okelio në poemë qëndron vargu i njohur homerik “*Virtuti më i vyer mbetet mbrojtja e atdheut*” Po ashtu, apostrofi prezantues i poemës, “*O djemt’ e Mëmëdheut, o trima Atdhetarë!! Të ditur, të dëgjuar, e burra kordhetarë/...*” të kujton po Iliadën. Të njëjtën ide përvijon këmbimi i trajtave të ligjërimit, nga ai rrëfyes në ligjërimit në vetën e parë apo edhe aplikimi i dialogut të paplotë, ose si pyetje retorike.

Konstrukti i poemës dhe ligjërimit tematik të kujton gjithashtu pjesën e parë të poemës së famshme të poetit grek Dh. Sollomos “Himn i flamurit”, 1823, shndërruar në kohën e revolucionit grek në himn kryengritës dhe më pas në tekstin e himnit kombëtar të Greqisë.

²⁴ Rexhep Qosja, Porosia e madhe, Prishtinë, 1986, f. 54.

Realitete historike e ideologjike të mishëruar në poemë

Poema u shkrua në periudhën kur “Krizja e Lindjes”, si shprehje e shpërbërjes së Perandorisë Otomane dhe e fillimit të proceseve labirint në formimin e kombeve shtete në Ballkan dhe Evropën Lindore (proces i vështirësuar më shumë nga përplasia e interesave të Fuqive të Mëdha), kishte futur në dilemë ideologët e shqiptarizmit, sidomos në Epir. Ata shikonin realitetin e popujve të Ballkanit dhe nxitjen evropiane për pavarësi duke u çliruar nga P. Otomane. Shikonin, gjithashtu, se, përveç situatave të brendshme që nuk lejonin kohezionin e një lëvizjeje të shëndetshme kombëtare, interesat e aktorëve vendimarrës binin ndesh me ëndrrën që ushqente në një rast të tillë P. Otomane për trashëgimin prej popullsive myslimane të territorëve të saj në Ballkan.

Kjo e fundit shkonte përshtat me bindjen shqiptare se P. Otomane ishte mbrojtëse e interesave të tyre në rajon. Siç u tha, kjo sjellje ishte produkt i marrëdhënieve të avancuara të shqiptarëve me P. Otomane, gjë për të cilën i qorton ashpër dhe Naimi. Po ashtu, Porta e Lartë në këtë periudhë, sidomos me Abdyl Hamitin, ndërmori hapa të dukshëm në promovimin e identitetit shqiptar. Kjo dilemë shqiptare u evidentua dhe tek Lidhja e Prizrenit, e cila sipas historianit Mark Mazower nuk kishte arritur të jipte një përgjigje të qartë mbi aspiratat e vërteta shtetformuese të “*shqiptarizmit*”²⁵.

Ndërkohë, në zonën e Epirit bashkëjetesa e gjatë ndërfetare dhe ndëretnike kultivonte paralelisht një bashkëpunim kundër pushtimit Otoman. Ndikonte në të klima e ideologjisë kombëtare neohelene që lulëzoi në Janinë, zbatimi praktik i së cilës në revolucionin grek të 1821-it nuk përfshiu Epirin. Kjo lëvizje bashkëpunuese deri tek ideja e një shteti konfederativ, nisi me idenë e Kollokotronit më 1823-in dhe do të zbehet në fillim të shekullit XX. Nga të dyja palët u angazhuan figura të shquara të kulturës, politikës dhe të veprimeve luftarake. Nga pala shqiptare përmendim Zenel Gjolekën, Rapo Hekalin, për një kohë Abdyl Frashërin si edhe Ismail Qemalin, Fan Nolin, Faik Konicën etj.²⁶ Sido që të jetë, realiteti përputhës edhe në Epir nuk u bë asnjëherë dominues. Interesat fuqive të mëdha dhe të P. Otomane të shprehura në krijimin e shtetit shqiptar të qëndrueshëm ushqeun klimën e përplasjes me fqinjët.

Në përgjithësi, në aspektin ideologjik e politik çoi në një diferencim të dukshëm nga popujt e tjerë të Ballkanit përsa i përket ballafaqimit “NE” dhe “TË TJERËT”. Për shqiptarët po vetëpërcaktohej si raport kundërshtie me fqinjët. “*E kishin marrë për armike, atë që, padashur, paskësh qenë mbrojtësja e tyre kundër sllavëve e grekëve?*” pyet qartësisht edhe pse në formë retorike I. Kadare tek sprova “Mosmarrëveshja, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten”²⁷.

²⁵ Mark Mazower, The Balkans: A Short History, Athinë, 2008, f. 156-160.

²⁶ Παναγιώτης Μπάρκας, Τα ταξίδια της Φηγοῦ, v. II, Ελίκρανον, Αθήνα, 2016. f.120 -129

²⁷ Ismail Kadare, Po aty, f. 59.

Vetë Naimi nuk e trajton në poemë P. Otomane si armikun kryesor nga i cili shqiptarët duhej të çliroheshin. Boshti i tij në poemë synon t'u tregojë shqiptarëve origjinën e tyre të lashtë me histori të lavdishme dhe t'u kërkojë fqinjëve dhe Evropës t'i respektojnë ata me këto cilësi dhe virtyte si shpëblim për shërbimet që shqiptarët u kanë ofruar historikisht.

*“ Historia vetë trimeritë e të parëve rrëfen,
Si shkabonjat fluturuan në erërat aziatik,
Luftuan Darion, fronin ia rrëzuan,
Fundin sollën të perseve barbarë,
Qytetërisë i dhanë shpëtim edhe liri.
Prap si luanë trima u derdhen, kësaj herë
Në Romë dhe tmerruan romakët legionarë...”²⁸*

*“ Demosteni, rrëfen Plutarku dhe Straboni
Dhe të tjerë shkrimtarë pohojnë më të madhe,
Ngaherë kombi ynë ka qenë siç edhe është,
Trim, madhështor, fisnik dha hyjnor...”²⁹*

*Allvanos-i ishte i pari siç ka qenë,
Thesprotë, mollosë, ilirë maqedonas.
Të gjithë ishin ashtu siç edhe janë allvani,
Armiq të kurrë s'ia dolën mbanë,
Kombin dhe gjuhën të na thajnë.*

.....
*Kordhëtarë trima gjithmonë në lufta,
Flijimin e jetës preferonin për Atdhe.
Helenë, sllavë e të tjerë, keltë, sqithë, romakë
Para shqiptarëve të huaj ishin”³⁰*

Naimi u referohet në poemë egërsive të pushtimit otoman në fillimet e veta dhe gjunjëzimit të Bizantit dhe botës së krishterë. Por më shumë e bën këtë për të hymnizuar qëndresën e Skënderbeut, të cilin e identifikon me të gjitha cilësitë e duhura për ta promovuar, si simbol krenarie shqiptare për gjithë Evropën, dhe si të tillë, të përcaktonte periudhën e tij luftarake si fillesën e etnogjenezës që u duhej shqiptarëve të kohës së tij për zgjimin e tyre kombëtar.

Poeti, pasi tregon paaftësinë dhe përulësinë e botës, në planin historik (grekët e

²⁸ Ναήμ Φράσσαρη, Ο αληθής πόθος των Σκουπετάρων, Sofie, 1903, f.4

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty. f. 5.

Poema e Naim Frashërit “O alithis pothos ton sqipetaron” (Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve)

lashtë, romakët e bizantinët) për të kundërshtuar pushtimin Otoman, në shekullin XV,

*“Perëndimi gjithë dridhej prej të frikshmëve barbarë”
“Në duart e tyre dha shpirt dhe vet Arusha e madhe,”*³¹

thekson se ai që ia doli ishte:

*“Heroi i vërtetë në botë i dëgjuar
Ishte Skënderbeu i allvanos-ve udhëheqës”*³²

Naimi, do t’i rikthehet figurës së Skënderbeut disa herë në poemë. Në këndvështrimin e tij dhe në emër të vijimësisë së lavdisë së shqiptarëve, poeti fton muzat hyjnore të thonë të vërtetën për epërsitë Skënderbeut edhe ndaj heronjve mitologjikë.

*“Këndo , o hyjni fisnike , trimërinë e rrallë të tij.
Lëri mitet e Homerit për këmbëshpejtin Akil
Lëre Enean adhuronjës dhe përrallat e Virgjilit,
Se hero i vërtet tani njihet nga të gjithë
Është prijësi i allvanos-ve, Skënderbeu i Madh.”*³³

Pavarësisht se në kërkesat e tij për qartësimin e raporteve në marrëdhëniet me grekët, në të gjitha fushat, përplasja duket e pashmangshme, Naimi di të vë re se, ndryshe nga fqinjët veriorë, me helenët, ekziston ai realitet bashkëpunimi që përmendëm më lart.

Dokumentet historike para dhe pas luftës ruso-turke të 1877 flasin për veprimtarinë politike dhe luftarake të personaliteteve shqiptare si Abdyl Frashëri, Zija Prishtina, Jani Vreto, Pashko Vasa etj të cilët ndërkohë që organizojnë rezistencë luftarake kundër fqinjve veriorë (“*Posht ato duar ju, o shqehë! Mërgohi Shqipërisë!*”- u drejtohet në poemë Naimi serbëve e malazezëve); vazhdonin bisedime të fshehta me Portën e Lartë për të përfituar përkrahjen e saj; përgatisnin marrëveshje për bashkëpunim konfederativ me Greqinë, kundër Turqisë.³⁴

Vargjet e poemës shndërrohen në pasqyrë kritike të kësaj situatë. Kur Naimi duke iu drejtuar grekëve thekson se “*Ju keni Greqinë dhe ne kemi Shqipërinë*” dhe brenda kësaj kornize kërkon të arrihet, miqësia, bashkëpunimi, vëllazërimi, është njësoj si të lexojmë në vargje marrëveshjet e papërfunduara për krijimin e aleancave greko-shqiptare kundër pushtuesve turq, me kushtet shqiptare për ruajtjen e identitetit, në gjuhë, fe, tradita, të shprehura në atë kohë nga A. Frashëri në Korfuz e Janinë dhe

³¹ Ναήμ Φράσσαρη, Po aty, f.6

³² Po aty. f. 6

³³ Po aty .f. 7.

³⁴ Nathalie Clayer, Po aty. f. 223-224

më parë nga Z. Gjonleka³⁵.

Naimi, pa hyrë në terma konkrete, i kushton një hapësirë të konsiderueshme kësaj ideje. Madje, ai bën përpjekje jo të pakta për të evidentuar, sipas tij dhe me referenca historike, pikat e kontaktit, mbivendosjes dhe të ndarjes midis shqiptarve dhe helenëve, në gjeografi, mitologji, histori, civilizim, heronj, perëndi etj. Sipas Naimit epërsia e “shqipëtarëve” është e dukshme dhe në të gjitha drejtimet. Kuptohet që trajtesat naimjane në këtë drejtim dhe pavarësisht qëllimeve që dihen janë të një natyre thellësisht subjektive deri në kapërcim dhe të vetë qasjes romantike të historisë.

Shembull tipik, që madje çorientoi përkthyesit dhe interpretuesit e poemës së Naimit, është ngjashmëria fonetike ose homonimia e dy toponimeve në Epir. Fjala është për malin Tomaros, afër orakullit të Dodonës ku ekzistonte dhe tempulli i famshëm i Zeusit Dodonas, të cilit i rreferohet poeti dhe malin Tomorri, afër Beratit, që flasin përkthyesit.

Thotë poeti:

*“Banonte ngaherë Zeusi në gjirin e Shqipërisë
Dhe në Tomaron e shenjtë tembull të bukur kish
Popujt të gjithë vinin me perulësi
Admironin perëndinë e kësaj Shqipërie.”*³⁶

Megjithatë, duhet thënë se Naimi është më i moderuar dhe më pragmatist për kohën, se pararendësit e po kësaj ideje, Masci, De Rada, Dorsi etj. Vetë titulli i poemës “Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve” e artikuluar në greqisht shpreh këtë bindje të tij.

Reflektimi i këtyre realiteteve në poemën e Naim Frashërit

Interesimi i menjëhershëm i Naimit në poemë është që t’u gjejë “*djemve të Mëmëdheut*” një shtrat të shëndoshë historik, sa më të vjetër, sa më të lavdishëm.

Ndryshe nga grekët, që këtij qëllimi i shërbeu qytetërimi i antikitetit helen, Naimi do të kërkojë në poemë zanafillën e këtij rrugëtimi historik për shqiptarët në një realitet tejhyjnor, te Pellazgët, të cilët, sipas tij:

*“Pellazgë jemi ne, lindur dhe para Hënës,
Kur Adami akoma qe ujë dhe rerë.
Jo prindër të njerëzisë të parët tanë qenë,*

³⁵ Παναγιώτης Μάρκας, Po aty. f. 120-129

³⁶ Ναήμ Φράσσαρη, Po aty. f. 4

Poema e Naim Frashërit “O alithis pothos ton sqipetaron” (Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve)

*Por edhe Perëndivet vetë prindër ata qenë”*³⁷

Si të tillë, sipas poetit, ata janë:

“Pasardhës zëmërluanë të të Madhit Aleksandër,

Të Piros legjendarit dhe të tjerëve heronj

*Femijë të Skëndërbeut, të atit kordhëtar”*³⁸

Për Naim Frashërin, sistemi linear i origjinës shqiptare kalon nga pellazgët, tek ilirët, tek heronjtë mitologjikë e historikë të antikitetit grek dhe periudhës helenistike, për të arritur tek Skënderbeu. Hiperbolizimi i faktit se shqiptarët i paraprijnë sistemit kohor të krijimit të gjithësisë, përbën treguesin e rëndësisë që ka për poetin përcaktimi i thellësisë kohore në origjinën shqiptare (aspekti romantik i konceptit për kombin).

Në këtë logjikë poeti preferon linjën e kombit me bazë racën dhe gjuhën (jo fenë, të cilën në poemë e respekton, nuk e konfliktohet me të, por as absolutizon rolin e saj në çështjen e identitetit etnik).

“Demosteni tregon, Plutarku, Straboni

Si dhe të tjerë autorë, të gjithë e pohojnë

Qëmoti kombi ynë ka qenë si tani

Trim, madhështor, fisnik, i perëndishëm

*Ishin si edhe ne, shqipëtarë të kulluar...”*³⁹

Dhe shton:

“Kombi i allvano-ve kurrë nuk e ndryshoi

Karakterin, gjakun, gjuhën dhe gjithçka

Në shekuj të pandryshueshme ato mbesin

*Allvanos-i është ai i pari, siç ka qënë.”*⁴⁰

Në këtë logjikë Naim Frashëri përcakton edhe kufijtë e territorit kombëtar:

“Thesprotë, mollosë, ilirë dhe maqedonas.

*Të gjithë ishin allvano i siç janë akoma”.*⁴¹

Një ballafaqim shkencor lidhur me historinë dhe gjeografinë e Epirit, bind se me këtë qasje poetike, edhe pse brenda linjës romantike në trajtimin e historisë, Naimi “pretendon” për territore etnike edhe vendet nën pushtimin otoman të administruar dhe qeverisur nga shqiptarët.

³⁷ Po aty. f. 1

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty. f. 4

⁴⁰ Po aty. f. 5

⁴¹ Po aty.

Gjergj Kastrioti, etnogjeneza shqiptare dhe etnonimi “sqipëtar” (qasja romantike e historisë)

Siç u theksua, Gj. Kastrioti përbën për Naimin, simbolin etnik, të cilin ai do ta shndërrojë në flamur të lëvizjes të kombëtarësisë. Në përgjithësi, ai synon kultivimin e ndërgjegjes kombëtare dhe funksionimin e saj “*si ndërgjegje morale*”.⁴²

16

Δὲν εἶναι ὁμοῦ οἱ οἶον, ἡμετέραντες ἀδελφοί,
 Ἀπὸ τοῦ αἵματός, ἡ πατρίδος, ἀπὸ τοῦ
 ὅμοῦ οἱ κοινὸς ἡμετέρι τοῦ Ἰλλυριανοῦ τῶν Μπεῶν
 Τὴν μετὰ τὴν ἡμετέραν, εἴσαν, καὶ ἀγάπην,
 Τὴν ἀδελφότητα ἡμῶν, τὴν ἀνεξαρτησίαν
 Τὴν αἰώνιον σὺν τῇ ἐλευθερίᾳ, σὺν τῇ ἐλευθερίᾳ,
 Τὴν ἀνεξαρτησίαν, τὴν ἐλευθερίαν, τὴν ἀνεξαρτησίαν,
 Καὶ τὴν ἐλευθερίαν πάντοτε ὑπὲρ τῆς τοῦ αἵματος.
 Ὡστε ὁ πᾶς ἡμετέρας εἶναι πᾶσις ἐλευθερία.
 Καὶ ὁ Πανηγύριος εἶναι, μετὰ ἡμῶν εἶναι πάντα.
 Τὰ ἡμέτερα τῆς ἡμετέρας καὶ τὸ φῶς τῆς πατρίδος
 Τὴν πατρίδα καὶ ἡμετέρας τοῦ αἵματος καὶ ἡμετέρας,
 Καὶ ὅτι τὴν ἀδελφότητα καὶ τὴν ἐλευθερίαν,
 Ἀπαντα ὅτι τὴν ἀγάπην, ὅλας τὰς ἐλευθερίας,
 Καὶ τὴν αἰώνιον τὴν ἐλευθερίαν, καὶ τὴν ἐλευθερίαν,
 Καὶ πάντοτε τὴν ἐλευθερίαν ἡμῶν ἐντὸς τοῦ αἵματος.
 Αὐτὰ ὅτι ὁ ἀδελφότητος ἐξέρχεται καὶ τὴν ἐλευθερίαν,
 Καὶ ὁ ἀδελφότητος ἡμῶν εἰς τὴν ἀνεξαρτησίαν.
 Ζήτω λοιπὸν ἡ ἡμετέρα καὶ, Ζήτω ἡ Σκυπερία!
 Ζήτω τὸ ἔθνος αἰεὶ! Ζήτω ἡ ἀδελφότης!
 Κάτω ἐξελθὲ καὶ τὴν ἀνεξαρτησίαν! Κάτω ὁ αἵματός καὶ ἐξελθὲ!
 Ζήτω ἡ Μπεῶν! καὶ τὸ φῶς, Ζήτω ἡ ἐλευθερία!

Τέλος,

Faqja e fundit e poemës

Këtu është me vend të vihen re etnonimet që përdor Naimi në funksion të ideve të veta. Ai përdor si etnonime për kombin ato të artikuluar nga grekët “Allvanos-Allvania”⁴³ dhe “sqipëtar-Sqipëria”. Të dytin e përdor po në greqisht dhe që në titullin e poemës, “O alithis pothos ton sqipetaron”. “*Jemi vetëm allvani, jemi sqipëtarë*”, thotë poeti për t’u diferencuar nga grekët. Ndërkohë për të treguar prejardhjen pallazgjike preferon më shumë etnonimin “sqipëtar” se sa “allvani”.

Dihet se etnonimi “Shqiptar” është i vonë dhe i takon periudhës së pas shekullit XVIII⁴⁴. Dihet gjithashtu se ende nuk ka një variant të pranuar e përfundimtar për prejardhjen e tij. Midis shumë teorive, sipas studiuesit grek Thanasis Margaritis⁴⁵ fjala “sqipëtar-Sqiperi, është fjalë e përbërë me prejardhje nga greqishtja e vjetër. Përbëhet nga fjalët “skii-σκιή” që në dialektin jonian, thotë ai, do të thotë skia,

⁴² Rexhep Qosja, Po aty, f. 471.

⁴³ Duke iu referuar H. Pedersen, Eqrem Çabej në librin e tij “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”, Tiranë 1994, f.11, shënon se: “Grekët e ndryshuan emrin (në allvanos, shën P.B) pas një asocacioni të errët me emra gjeografike të tjera”.

⁴⁴ Eqrem Çabej, Hyrje në Historinë e Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1976, f. 27.

⁴⁵ Θανάσης Μαργαρίτης, Αλβανία ελληνική πανάρχαια γη, Αθήνα, 1994, f. 91.

hije –σκιά dhe fjala “perioks+ogos-περιρροξ-ώγος» do të thotë vend i fshehtë nga të gjitha anët, shkëmbor, i pjerrët. Dhe në Shqipëri, thotë Margariti, etnonimi në fjalë përdoret për të karakterizuar vendin shkëmbor, gjë që në fakt përdoret shpesh në ligjerimin poetik në vendin tonë. Nga vëzhgimet tona studimore rezulton se në periudhën e Naimit dhe para tij, përdorimi i etnonimit “sqipëtar” përdorej për të dalluar pjesën “e pastër” të shqiptarëve, sa i përket raporteve bashkëpunuese me pushtuesin otoman.⁴⁶

Në këtë këndvështrim, Naimi duket se ndikohet pikërisht nga nevoja e identifikimit të bashkëkombësve të tij me “pastërtinë racore” shqiptare, të shprehur te etnonimi relativisht i ri, “sqipëtar”, për ta përdorur atë si tregues të vijimësisë së kësaj pastërtie racore që prej lashtësisë, para pellazgëve, por pa e ndarë nga etnonimi “allbanos”.

E vërteta është se, në lidhje me etnogjenezën shqiptare dhe nevojën për t’i treguar Perëndimit argumente bindëse, jo vetëm Naimi, por në përgjithësi Lëvizja e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, ruajti pikërisht këto linja. Shpalli origjinën pellazgjike me vijimësi ilirike dhe caktoi si momentin historik më të rëndësishëm etnogjeneze periudhën e Skënderbeut. Kjo nuk lidhet me faktin e afërsisë historike me të, porse “atleti i krishtërimin” ishte shumë i njohur në Perëndim. Nga ana tjetër simboli i tij prej prijësi ishte i pranueshëm për aktualitetin shqiptar, pasi ata, shqiptarët, duhet të fitonin lirinë nga i njëjti armik. Për himnizimin e Kastriotit, Naimin nuk e pengoi, ashtu si të gjithë ideologët e tjerë myslimanë të Rilindjes, fakti që ata i përkisnin së njëjtës feje me këta pushtues, ashtu siç ishin edhe të kundërt me të.

Poema e Naimit dhe aspekti iluminist në të

Në planin horizontal-krahasues, (aspekti iluminist), qëllimi lidhet me promovimin e lashtësisë, bashkë me racën edhe gjuhën, kulturën, diturinë e shqiptarëve si mundësi dhe mënyrë për të sjellë zgjimin e tyre kombëtar, por edhe për të fituar admirimin e Perëndimit. Kështu shpjegohet edhe fakti që në atë periudhë, vetë Naimi, vëllezërit e tij dhe gjithë plejada e ideologëve të Rilindjes shkruanin në shumë gjuhë, perëndimore e lindore, botonin shkrime të kësaj natyre në gazetatat dhe revistat të rëndësishme perëndimore, botonin libra etj.

Naimi i shmanget në poemë faktorit fe edhe në kultivimin e kohezionit të brendshëm shqiptar dhe të unitetit të popullit. Për këtë i mëshon me prioritet lashtësisë së gjuhës dhe të dijes. Vargjet e mëposhtme në mbyllje të poemës, janë domethënëse:

*“Shkronjat e gjuhës tonë dhe drita e arsimit
Do të sjellin mbrothësinë e kombit tonë fisnik*

⁴⁶ Παναγιώτης Μπάρκας, Po aty, f. 246-252.

*Të shumë kërkuarën vëllazërinë dhe lirinë
Dhe të gjitha mirësitë bashkë edhe begatitë*

.....
*Dhe praninë tonë në gjirin e botës
Armiqtë do t'i zhbëjnë dhe tiraninë bashkë
Dhe do na lartësojnë në majën më të lartë.”⁴⁷*

Pikërisht, një qasje e tillë iluministe bëhet për poetin shprehje e garancisë së marrëdhënieve të mira fqinjësie:

*“Ne jemi allvani dhe ju helenë jeni
Ju keni Elladhën tuaj, ne kemi Shqipërinë
Keni ju gjuhën tuaj dhe tonën kemi ne.
Kjo është rruga e mirë që miqësia të bëhet
Të përparojmë duam me gjithë gjitonë bashkë
Me sllavë dhe me helenë në harmoni të paqte”⁴⁸*

Përse poeti zgjodhi gjuhën greke për këtë vepër të rendësishme të tij

Poema, thamë, mishëron programin politik kombëtar të Rilindjes Shqiptare. Zgjedh skemën ideologjike të shkrirjes në një të iluminizmit dhe antipodit të tij romantizmit. Dhe, flet për realitete shqiptare me një gjuhë të lakmueshme greke.⁴⁹

Naimi kurrë nuk zbuloi arsyet përse zgjodhi greqishten për të promovuar këtë program politik kombëtar.

Disa nga arsyet mund të përvijohen:

Greqishtja ishte gjuha e elitës ballkanase të kohës. Ishte njëkohësisht gjuha e fesë sunduese në Ballkan. Në radhë të parë Naimi donte t'i drejtohej Greqisë, se e kuptonte që marrëdhëniet historike me popullin grek nuk mund ta bënin të thjeshtë qartësinë etnike në aspektin e territorit, por edhe në aspektin antropologjik, sociologjik, fetar e kulturor. Në përgjithësi dhe në të gjitha nivelet Naimi vendos në poemë raporte kundërshtie dhe epërsie me grekët. Pavarësisht kësaj, ai arrin të jetë konstant në kërkesat për fqinjësi të mirë, miqësi, paqe e vëllazëri me Greqinë.

Ishin të shumtë shqiptarët të cilët nuk kishin mundësi të arsimoheshin në gjuhën amtare me pasojë të kishin si gjuhë komunikimi dhe kulture gjuhën greke.

Lidhet me nevojën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Promovimin e programit dhe të aspiratave të veta tek faktori ndërkombëtar në një gjuhë të njohur dhe të

⁴⁷ Ναήμ Φράσσαρη, Po aty. f. 16

⁴⁸ Po aty. f. 11

⁴⁹ Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Prishtinë, 1988, f. 314.

Poema e Naim Frashërit “O alithis pothos ton sqipetaron” (Dëshirë e vërtetë e shqipëtarëve)

afirmuar siç ishte gjuha greke.

Lidhet me nevojën për të treguar rëndësinë që ka kultura greke në jetën e tij. Për të treguar atë dashuri që kishin të gjithë romantikët për kulturën klasike greke.

BIBLIOGRAFIA

Dhimitër S. Shuteriqi, Naim Frashëri (Jeta dhe vepra), Tiranë, 1982.

Eqrem Çabej, Hyrje në Historinë e Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1976.

Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë, 1994.

Eqem bej Vlora, Kujtime v.I, SH.LK, Tiranë, 2002

George W. Gawrych, The Crescent and the Eagle, -London-New York, 2006.

Girolamo de Rada, Divinazioni pelasgiche, Lucifero, 1840.

Ismail Kadare, Mosmarrëveshja mbi raportet e Shqipërisë me vetveten, Tiranë, 2010.

Jup Kastrati, Historia e Albanologjisë, Tiranë, 2000

Mark Mazower M, The Balkans, Athinë 2008.

Miranda Vickers, The Albanians, a modern history, London-New York, 1995.

Nathalie Clayer, Aux origins du nationalisme albanais, La naissance d’une nation majoritairement musulmane en Europe”, Paris, 2007.

Petrika Thëngjilli, “Historia e Popullit Shqiptar 395-1875”, ShBLU, Tiranë 1999

Rexhep Qosja, “Naim Frashëri dhe gjendja shpirtërore e popullit”, në *Naim Frashëri dhe kultura shqiptare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë, 2001.

Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Prishtinë, 1988.

Rexhep Qosja, Porosia e madhe, Prishtinë, 1986.

Serge Berstein, Pierre Milza, Ιστορία της Ευρώπης: από την Ρωμαϊκή Αυτοκρατορία στα Ευρωπαϊκά Κράτη 5ος-18ος αιώνας, v. B’, Αλεξάνδρεια, Αθήνα, 1999.

Θανάσης Μαργαρίτης, Αλβανία ελληνική πανάρχαια γη, Αθήνα, 1994,

Κωνσταντίνος Τσουκαλάς, Παράδοση και εκσυγχρονισμός: μερικά γενικότερα ερωτήματα, στο Τσαούσης, Δ. Γ., (επιμ.), Ελληνισμός και ελληνικότητα, Αθήνα, 1983

Ναήμ Φράσσαρη, Ο αληθής πόθος των Σκυπετάρων, Sofie, 1903

Παναγιώτης Μπάρκας, Τα ταξίδια της Φηγού, ν. Π, Ελίκρανον, Αθήνα, 2016.

Παντελής Ε. Λέκκας, Το παιχνίδι με τον χρόνο: εθνικισμός και νεωτερικότητα, Ελληνικά Γράμματα, Αθήνα, 2001.